




# BULETINI INFORMATIV

JANAR—DHJETOR 2022



# Të hyrat tatimore mbyllin vitin 2022 me nivelin më të lartë të inkasimit të shënuar ndonjëherë

Tatimet dhe Kontributet Pensionale për periudhën Janar-Dhjetor




Autoriteti tatimor ka përmbyllur vitin 2022 me performancë të jashtëzakonshme të inkasimit, duke rritur të hyrat tatimore për 21.11%, të cilat rezultojnë më të lartat që nga themelimi i institucionit.

Këtë ritëm të inkasimit sigurisht e ka mundur përkushtimi maksimal i menaxhmentit dhe stafit të ATK-së, duke realizuar aktivitete të shumta, të cilat kanë përmirësuar performancën e ATK-së, duke u nisur nga inkasimi dhe trajtimi i borxheve, avancimi i vazhdueshëm i shërbimeve ndaj tatimpaguesve dhe qytetarëve, si dhe intensifikimi i bashkëpunimeve me institucionet e vendit.


Të gjitha këto aktivitete përveç se kanë bërë që ATK të jetë përtej planit, kanë dhënë rezultat edhe nëse krahasojmë me vitin 2021, ku kemi rritje për 12.3 milion euro apo 1.73%, ku totali i inkasimit arrin vlerën e 723.9 milion euro.

ATK po ashtu falënderon të gjithë tatimpaguesit që me vet-deklarim kanë arritur që të kemi një përqindje të konsiderueshme të përmbushjes vullnetare.



*Parimi i besueshmërisë: - të përpiqen të fitojnë besimin dhe respektin e komunitetit duke qenë konsultues dhe bashkëpunues, komunikimet tona do të jenë të forta dhe të besueshme dhe ne do të respektojmë këshillat e dhëna nga të tjerët. Rregullat dhe standardet tona do të bashkohen dhe zbatohen në mënyrë të drejtë.*

## Trajtimi dhe mbledhja e borxheve



Mbledhja dhe trajtimi i borxheve ka vazhduar të jetë edhe në këtë vit njëri ndër prioritetet e ATK-së, për të gjithë tatimpaguesit të cilët kanë obligime (borxhe tatimore) të pakryera. Aktivitetet me masa të sforcuara kanë karakterizua këtë vit me aksione tek 282 subjekte biznesore, të cilat kishin 36.5 milion euro borxhe. Në kuadër të këtyre aksioneve janë realizuar pagesa të pjesshme të obligimit si paradhënie, bazuar në marrëveshjet e lidhura në shumë 13.5 milion euro.



Janë konfiskuar pasuri të paluajtshme tek tre tatimpagues, si dhe janë në procedura të shitjes sipas legjislacionit në fuqi.

Referuar statistikave të përgjithshme nga Departamenti i Mbledhjes së Detyrueshme, këtë vit janë mbledhur 156.7 milion euro borxhe tatimore.

Pagesa e borxhit me marrëveshje numëron 2,497 tatimpagues më shumë të borxhit 100.5 milion euro, pagesat e kryera nga këto marrëveshje janë në shumën prej 41.7 milion euro. Totali i inkasimit të borxheve dhe inkasimit të marrëveshjeve arrin vlerën 257.1 milion euro.

Administrata Tatimore i njofton të gjithë tatimpaguesit që kanë obligime të papaguara, të kontaktojnë Departamentin e Mbledhjes së Detyrueshme dhe të paguajnë detyrimet tatimore, në mënyrë që të mos ballafaqohen me masa të konfiskimit, si dhe të janë bashkëpunues në pagesën e borxheve të tyre dhe të njoftohen për mundësit që ofron Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat në shlyerjen e borxhit tatimor.

## Gjobat mund të paguhen vetëm 50%, nëse paguhen brenda 15 ditëve



Administrata Tatimore e Kosovës, gjatë këtij viti ka njoftuar të gjithë tatimpaguesit se ka aprovuar Rregulloren e brendshme të ATK nr. 01/2022 mbi Përcaktimin e procedurave për funksionimin e Njësive organizative për Gjoba dhe Ndëshkime (ZGjoNA), e cila ka filluar të zbatohet nga data 01.02.2022.

Ndër të tjerash, me këtë Rregullore janë përcaktuar edhe procedurat pas vendimmarrjes nga ZGjoNA.

Bazuar në këtë Rregullore, tatimpaguesit ndaj të cilëve ZGjoNA shqipton gjoba fikse për shkelje të legjislacionit tatimor, kanë mundësinë që të përfitojnë zbritje nga pagesa e tërësishme e shumës së gjobës.

Në rast se tatimpaguesi paguan gjobën e shqiptuar brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit nga ZGjoNA, tatimpaguesi lirohet nga pagesa e pesëdhjetë përqind (50%) të shumës së gjobës së shqiptuar dhe në këtë rast procedura e ankimit siprimohet dhe rasti konsiderohet i mbyllur.

Tatimpaguesi i cili nuk paguan gjobën prej pesëdhjetë përqind (50%) brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, obligohet të paguaj gjobën prej njëqind përqind (100%) të shumës së përcaktuar me Vendim nga ZGjoNA.

Të drejtën për të përfituar nga pagesa e gjobës vetëm prej pesëdhjetë përqind (50%) e kanë të gjithë tatimpaguesit.



## ATK me pesë projekte për rritjen e përmbushjes

Viti 2022, është karakterizuar me projekte të ndryshme në kuadër të Administratës Tatimore të Kosovës, të cilat do të trajtojnë segmente të caktuara, ku sipas Planit vjetor të punës dhe Planit të Trajtimit të Rreziqeve, janë fusha të cilat paraqesin hendek tatimor.

Me synim të përmirësimit të përmbushjes tatimore, këta sektorë do të trajtohen përmes këtyre projekteve:

Projekti “Ndërtimtari” (në vazhdimësi nga viti 2019);

Projekti “Punësimi joformal apo punës së padeklaruar” (në vazhdimësi nga viti 2021);

Projekti “Akomodimi dhe Shërbimi Ushqimor”

Projekti “Mos-deklaruesit”

Projekti “Mungesa në stoqe & malli pa origjinë - Tregtia me shumicë”

Qëllimi i realizimit të këtyre projekteve është rritja e përmbushjes tatimore, edukimi tatimor i bizneseve për obligimet që kanë ndaj ATK-së, rritjen e komunikimit me tatimpagues, si dhe luftimin dhe zvogëlimin e informalitetit.

Implementimi i projekteve të lartcekura kërkon shtrirjen e bashkëpunimit edhe me institucionet tjera, të cilat kanë në fokus këto veprimtari, me qëllim të intensifikimit të këtij bashkëpunimi, gjithnjë për të garantuar zbatimin e ligjshmërisë dhe cilësi në rezultate.

# ATK me plan veprimi për sektorin e ndërtimtarisë



Administrata Tatimore e Kosovës është e përkushtuar që të përmirësojë qasjen e saj në menaxhimin e rreziqeve të përmbushjes tatimore, për të siguruar që përpjekjet për përmbushje të adresojnë rreziqet kryesore, që e përbëjnë pjesën më të madhe të hendekut tatimor.

Plani për Përmirësimin e Përmbushjes në Sektorin e Ndërtimtarisë është duke vazhduar implementimin e tij, ku përmes këtij plani ATK do të kryejë aktivitete intensive me qëllim të identifikimit të personave, të cilët nuk përmbushin detyrimet e tyre sipas legjislacionit tatimor.

Me fokus të veçantë, do të identifikohet veprimtaria ndërtimore, siç është ndërtimi i ulët dhe i lartë, grupet punuese dhe personat fizikë në kuadër të veprimtarisë së ndërtimtarisë, si: muratorët, armaturë punuesit, betonime, gërmimet e dheut, punuesit e kulmeve, prodhimi dhe montimi i dyerve dhe dritareve, elektrikistët, instaluesit e ujit dhe ngrohjes qendrore, montuesit e parketit/laminatit, montuesit e qeramikës, suvatuesit – fasada, prodhimi dhe montimi i olluqeve, rrethojave të ballkonëve, shkallëve dhe rrethojave të oborreve nga metalet e ndryshme dhe druri, etj.

Aktivitetet përmbushëse për sektorin e ndërtimtarisë, do të ndërliken me një strategji gjithëpërfshirëse për përmirësimin e përmbushjes. Qëllimi është që të zbatohet një qasje bashkëvepruese në trajtimin e riskut, fillimisht në sektorin e ndërtimtarisë me qëllim të arritjes së një niveli më të lartë të përmbushjes duke reduktuar hendekun tatimor.

Me kryerjen e detyrimeve tuaja tatimore, ju kontribuoni direkt në ofrimin e shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, shërbime më të mira shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie të qëndrueshme ekonomike dhe shoqërore.

# Projekti për trajtimin e mallit pa origjinë dhe mungesës në stoqe



Projekti i radhës i cili nis së implementuari është projekti i përmbushjes “Mungesa në Stoqe & Malli pa Origjinë”, i cili ka për qëllim të përmirësojë përmbushjen tatimore në sektorin e tregtisë me shumicë, duke përfshirë të gjithë faktorët që ndikojnë dhe ndikohen nga ky sektor në mënyrë më të fokusuar dhe më të koordinuar.

Grupet e synuara për trajtim përmes këtij projekti janë; industria e tekstilit, tregtia me shumicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, tregtia me shumicë e artikujve shtëpiakë, tregtia tjetër me shumicë e specializuar, tregtia me pakicë në dyqane jo të

specializuara, tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara, tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara, dhe të tjera

Ekziston ende një numër i konsiderueshëm i tatimpaguesve të cilët kanë problemin e mallit pa origjinë si rezultat i blerjeve pa fatura, po ashtu shitje të pa deklaruar. Bazuar në të dhënat e përmbushjes gjatë vitit 2021, shihet se edhe dukuria e mallit pa origjinë dhe mungesës në stoqe renditet si ndër dukuritë me nivel të lartë të riskut dhe janë identifikuar si aktivitete më me risk.



# Aktiviteti i hotelerisë dhe gastronomisë në monitorim specifik



Industria e Akomodimit dhe Shërbimit Ushqimor (gastronomi/hoteleri), bazuar në të dhënat e përmbushjes gjatë vitit 2021, renditet si njëra ndër industritë me nivel të lartë të mos-përmbushjes së detyrimeve tatimore, andaj edhe është pjesë e planeve specifike të përmbushjes për grupet e identifikuara me rreziqe të larta për vitin 2021.

Ndër problemet më specifike, të dala nga sistemet dhe modulet e ndërtuara përbrenda ATK-së, të cilat kanë kontribuar në këtë përzgjedhje të trajtimit të kësaj industrie janë: pagesa përgjithësisht të ulëta, me një kontribut të vogël në të hyra, pavarësisht numrit të madh të tyre; mos-deklarimi i punëtorëve dhe pagesa cash e tyre; mos-deklarimi apo nën-deklarimi i ahengjeve dhe mos-mbajtja e evidencave lidhur me këngëtarët gjatë mbrëmjeve muzikore; mos-lëshimi i kuponëve fiskal; pagesat po ashtu në Cash të realizuara në mes të konsumatorëve dhe bizneseve gjatë organizimit të ahengjeve të ndryshme; si dhe mos mbajtja e tatimit në qira apo nën-deklarimi i saj.

Administrata Tatimore e Kosovës, kërkon nga secili tatimpagues nga çfarëdo aktiviteti ekonomik që zhvillon që t'i kryej përgjegjësitë e kërkuar tatimore që kalkulohen sipas legjislacionit tatimor, me qëllimin e vetëm që mos të jenë pre e ndëshkimeve tatimore.



# ATK prezanton projektin e radhës për “Mos deklaruesit”



Në mënyrë që të kemi përmirësim të përbushjes tatimore ATK ka hartuar projektin tjetër për “Mos deklaruesit”, përmes së cilit do të identifikoj tatimpaguesit, të cilët nuk përbushin detyrimet e tyre sipas Ligjit, pra identifikimin e tatimpaguesve që nuk deklarojnë dhe deklarojnë me vonesë.

Arsyeja e përzgjedhjes dhe identifikimit të kësaj kategorie të tatimpaguesve është bërë duke u nisur nga realizimi i qëllimit strategjik të ATK-së për përmirësimin e përbushjes tatimore sa i përket deklarimit dhe deklaruesve (deklarimit ) me vonesë meqenëse kjo kategori renditet me nivel të lartë të riskut.

Trajtimi i mos deklaruesve dhe deklaruesve me vonesë do të realizohet përmes aplikimit të aktiviteteve, si në vijim:

- Masat parandaluese, dhe
- Masat për trajtimin e mos deklaruesve.

Projekti do të zgjerohet për të adresuar rreziqet e mos deklarimit dhe deklarimit me vonesë duke përdorur një gamë të gjerë aktiviteteve duke përfshirë por duke mos u kufizuar edhe në aktivitetet e vizitave dhe kontrolleve tatimore.

Administrata Tatimore e Kosovës u bënë thirrje të gjithë tatimpaguesve që të deklarojnë dhe paguajnë tatimin saktë dhe në kohë.

# Raportimet për evazion tatimor

Nga janari deri me 31 dhjetor 2022 përmes vëlgës për verifikim të statusit nëse një punëtor është i regjistruar/i deklaruar nga punëdhënësi i tij, janë raportuar 167 raste denoncuese, përmes aplikacionit elektronik për verifikimin e punëtorëve.

Bazuar në projektin për formalizmin e punësimit ndër arsyt kryesore që kanë kontribuar që punësimi joformal të trajtohet si i tillë janë nën-deklarimi i pagave, pagesa e pagave në dorë, të punësuarit pa kontrata pune, etj. Të gjitha pikat e përmendura janë evidentuar edhe në raportet dhe anketat e bëra nga Banka Botërore, raportet e financuara nga Bashkimi Evropian, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Akademia e Shkencave të Kosovës, Njësia e Inteligjencës Financiare, si dhe nga Institucionet tjera, dhe të gjeturat nga ATK në terren.

ATK fton të gjithë punëtorët që t'i bashkohen kampanjës së ATK-së, duke shfrytëzuar këtë aplikacion, pasi që vetëm në këtë mënyrë do të arrijmë që t'i ulim statistikave të punëtorëve të pa formalizuar, duke mundësuar realizimin e të drejtës tuaj për një të ardhme me një pensionim të sigurt.

Aplikacion mund ta gjeni në ueb faqen e ATK-së <https://apps.atk-ks.org/regemployer>

Veç kësaj, raportime nga qytetarët kemi pas edhe nga kanalet tjera, të cilat janë në dispozicion, si linja për raportim 088 80 800 dhe kutia e vërejtjeve.

Linjat e raportimeve në vitin 2022	Nr. Informatave të pranuar deri me date 22.12.22	Nr. i aktiviteteve kthyes	Nr. i gjobave të lëshuara nga regjionet	Shuma e gjobave	Shuma e Qarkullimit Shtesë	Nr. Punëtove të deklaruar
Kuti të vërejtjeve dhe E-mail <a href="mailto:standardet.profesionale@atk-ks.org">standardet.profesionale@atk-ks.org</a>	1,127	807	564	309,698	355,404.48	
Qendra e thirrjeve Linja 0800/80-800	1,085	750	486	116,000	296808.04	
Aplikacioni për punësim	167	106	37	7,325	25,884.77	28
<b>TOTALI</b>	<b>2,379</b>	<b>1,663</b>	<b>1,087</b>	<b>433,023</b>	<b>678,097.29</b>	<b>28</b>

# Raportimet për evazion tatimor

Gjatë këtij viti Departamenti i Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës me theks ka punuar në investigimin e rasteve specifike, të cilat vullnetshëm ose jo i shmangen obligimeve tatimore.


Janë 25 raste të hapura, nga sektorë të ndryshëm. Ndër sektorët të cilët këtë vit ka pas vëmendje të veçantë kanë qenë: diskotekat, artistët e estradës, përfitimet nga rrjetet sociale, internet/marketing, kripto, shpronësimet, shitblerja e aksioneve.

Bazuar në informatat e siguruara nga rrjetet sociale përmes veglave analitike por edhe informatave të pranuar nga institucionet tjera për zbatimin e ligjit, janë hartuar raporte të inteligjencës, të cilat kanë dhënë këto rezultate:

	Qarkullim shtesë	Tatim shtesë	Ndëshkime 25 %
<b>Rrjetet sociale</b>	812,370.37	212,950.32	31,973.20
<b>Internet / marketing</b>	946,276.29	96,380.02	28,415.84
<b>Kripto</b>	199,387.13	47,726.59	7,140.85
<b>Shpronësimet</b>	5,886,378.04	218,886.90	54,721.72
<b>Shitblerja e aksioneve</b>	2,965,000.00	198,582.39	73,922.44

# Plani Strategjik 2022-2026

## Qëllimet Strategjike



Administrata Tatimore e Kosovës ka hartuar Planin Strategjik për vitin 2022-2026, në të cilin janë të përfshira këto objektiva; forcimi i mbledhjes së të hyrave dhe zvogëlimi i hendekut tatimor – maksimizimi i të hyrave të mbledhura dhe të pagueshme, sipas ligjeve të të hyrave të Kosovës; modernizimi i Administratës Tatimore – zbatimi i një sistemi të ri të administrimit të teknologjisë së informacionit, modernizimi i strukturave tona organizative, si dhe ngritja e kapaciteteve të stafit dhe kapaciteteve institucionale për t’iu përgjigjur mjedisit tonë të ri.

Gjatë periudhës së planit, ATK do të avancoj një sërë nismash reformuese për të ndërtuar një administratë tatimore moderne dhe efektive. Këto nisma do ta udhëzojnë hartimin e strategjive dhe veprimeve specifike në planet tona vjetore operative dhe strategjike.

Pjesë integrale e realizimit të planit tonë është kontributi i stafit tonë. Jemi krenar për profesionalizmin dhe përkushtimin e tyre dhe mirëpresim udhëtimin tonë të përbashkët dhe mbështetjen tonë për ndërtimin e vendit dhe rritjen ekonomike për të mirën e të gjithë popullit të Kosovës.

# ATK, nxjerr Vendimin Shpjegues Publik Nr. 01/2022 për procedurat e trashëgimisë ligjore të Biznesit Individual pas vdekjes së pronarit



Administrata Tatimore e Kosovës, nxjerr Vendimin Shpjegues Publik Nr. 01/2022 për procedurat e trashëgimisë ligjore të Biznesit Individual pas vdekjes së pronarit.

Qëllimi i këtij Vendimi Shpjegues Publik është që të sqaroj procedurat nga aspekti tatimor, lidhur me trashëgiminë e Biznesit Individual pas vdekjes së pronarit.

Ky Vendim Shpjegues Publik ju dedikohet të gjithë tatimpaguesve të cilët kanë statusin e personit fizik afarist (Biznes Individual), si dhe të gjithë zyrtarëve të Administratës Tatimore të Kosovës, të cilët angazhohen në shqyrtimin e kërkesave të tatimpaguesve, inspektime dhe kryerjen e kontrollave tatimore.

Vendimin Shpjegues Publik Nr.01/2022 – për procedurat e trashëgimisë ligjore të Biznesit Individual pas vdekjes së pronarit, mund ta gjeni në ueb faqen e ATK-së [atk-ks.org](http://atk-ks.org) në linkun Publikime – Shpjegime Publike.



## Ambasadori italian ka takuar drejtorin Murtezaj



Ambasadori italian në Kosovë, Antonello De Riu së bashku me ekspertët nga Guarda Di Financa kanë takuar drejtorin e ATK-së Ilir Murtezaj me bashkëpunëtor, ku diskutuan për përkrahjen që ambasada italiane mund t'i ofroj ATK-së. Me theks të veçantë palët folën për ngritjen e kapaciteteve profesionale për stafin e ATK-së.

Nga ana tjetër, drejtori Murtezaj njoftoj diplomacinë italiane rreth sistemit tatimor në Kosovë, zhvillimeve dhe reformave të fundit që janë bërë në ATK, ku njëherit kërkoj nga ambasadori De Riu që t'i ofrohet mbështetje me projekte konkrete, të cilat janë me interes për ATK-në.

Gjatë këtij diskutimi drejtori i ATK-së njoftoi ambasadorin rreth kushteve të favorshme për investitorët e huaj që ofron sistemi tatimor i Kosovës.

Ambasadori De Riu konfirmojë gatishmërinë për të analizuar dhe shqyrtuar mundësitë e përkrahjes dhe mbështetjes për institucionin e ATK-së.



## **z. Michael Ellis Ministër në Kabinetin e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar ka vizituar sot ATK-në**



Ministri i Zyrës së Kabinetit të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar z. Michael Ellis, si dhe Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë z. Nicholas Abbott, kanë vizituar Administratën Tatimore të Kosovës, konkretisht Drejtorinë e Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës, me ç’rast është pritur nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së Ilir Murtezaj dhe bashkëpunëtorët e tij.

Kjo vizitë u realizua më qëllim që të shihet nga afër mbështetja që i është dhënë ATK-së nga Mbretëria e Bashkuar, në fuqizimin e mekanizmave për investigimin e rasteve, të cilat qëllimisht i shmangin obligimet tatimore. Po ashtu, z. Ellis u njoftua edhe me avancimin që është bërë në këtë departament, nga ekspertizat e ofruar përmes pajisjeve softuerike, të cilat në masë të madhe kanë ndihmuar që hetimet tatimore t’i intensifikojnë aktivitetet e tyre.

Bashkuar është deri më tani e vetmja për këtë qëllim, duke shprehur se një mbështetje e tillë të vazhdoj edhe në të ardhmen.

E nga ana tjetër, Ministri i Zyrës së Kabinetit të Britanisë së Madhe z. Michael Ellis, u shpreh i kënaqur më punën që është bërë dhe progresin që është arritur falë mbështetjes nga vendi i tij. Veç tjerash, z. Ellis potencoj se do të vazhdojë mbështetja në ngritjen e kapaciteteve profesionale të institucionit të ATK-së.



# ATK mban ligjëratë para studentëve të Universitetit “Haxhi Zeka”



Se Administrata Tatimore e Kosovës ka në prioritet edukimin e brezave të rinj rreth rëndësisë së tatimeve, apo rreth kryerjes me kohë të obligimeve tatimore që lindin si rezultat i zhvillimit të veprimtarive ekonomike, e tregon edhe mbajtja e ligjëratës së Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së para studentëve të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë.

Në këtë ligjëratë Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së Ilir Murtezaj ka prezantuar para studentëve të këtij universiteti, sistemin tatimor në Kosovë. Studentët u njoftuan nga afër rreth asaj se çka tatimohet në vend, cilat janë normat tatimore, kush obligohet për të paguar tatimet, cilat janë llojet e tatimeve etj.

Po ashtu, veç kësaj studentët morën informata rreth çështjeve të tjera rreth përparësive të sistemit tatimor të Kosovës, si: sistemi i integruar i regjistrimit të biznesit (One-stop-shop), ngarkesa të ulëta tatimore, sistem i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë, shërbime elektronike (deklarimi, pagesat, etj.), si dhe mjedis i përshtatshëm biznesor.

Studentët shprehën interesim rreth kësaj ligjërate, të cilët po ashtu parashtruan pyetje të ndryshme rreth temave të cilat u prezantuan.

Administrata Tatimore e Kosovës në vazhdimësi organizon dhe i përgjigjet ftesave të ngjashme për ligjëratë me student dhe me nxënës, pasi që prioritet i institucionit është edukimi me kohë i brezave të rinj, me qëllimin e vetëm që të njëjtit në të ardhmen me krijimin e bizneseve të jenë të vetëdijshëm për atë që i obligon legjislacioni tatimor.

## Drejtori Murtezaj ligjëratë para studentëve të Fakultetit Ekonomik në Kolegjin AAB



Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së Ilir Murtezaj ka qenë i ftuar nga Kolegji AAB për një ligjëratë para studentëve të Fakultetit Ekonomik. Qëllimi i kësaj ligjërate ishte njoftimi i studentëve për sistemin tatimor në Kosovë, si dhe formimin në kohë të kuadrove të fushës së ekonomisë.

Studentëve të cilët nesër do të jenë brez i cili do të zhvillojnë vendin tonë, drejtori Murtezaj ju përmendi rëndësinë e tatimeve, ku sipas tij një shtet asnjëherë nuk do të mund të ketë mirëqenie, zhvillim, edukim pa pasur ndërgjegjësim në deklarinimin dhe pagesën e tatimeve nga secili subjekt biznesor, i cili nga aktiviteti ekonomik krijon të ardhura.

E nga ana tjetër, studentet u shprehën tejet të interesuar, ku parashtruan pyetje të ndryshme.

## Diskutim me bizneset anëtare të Odës Ekonomike Gjermano Kosovare



Në ciklin e organizimeve që Drejtoresha Ekzekutive e Odës Ekonomike Gjermano Kosovare Nora Hasani, ka bërë me institucionet publike dhe anëtarët e saj në muajin maj, i ftuar në tryezë diskutimi me afaristë të cilët janë pjesë e OEGJK-së, ka qenë drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës Ilir Murtezaj.



Sigurisht, temë diskutimi ishin zhvillimet e fundit në institucionin e ATK-së, si dhe shumë çështje të cilat janë relevante për bizneset, ku nga ana tyre pati edhe rekomandime për plotësim në disa procese. Po ashtu, u theksua se ATK ka shënuar progres të jashtëzakonshëm në avancimin e shërbimeve për bizneset, të cilat sipas tyre kanë ulur dukshëm koston e shpenzimeve, por edhe atë të resurseve humane (në aspektin administrimit). Veç këtyre, pjesë e pa shmangshme e diskutimit

ishin edhe vështirësitë që janë duke i hasur bizneset pas periudhës pandemike.

Nga ana tjetër, drejtori Murtezaj, shtoj se ATK është gjithnjë e hapur në avokimin e shumë çështjeve, të cilat janë në funksion të dyanshëm, pasi që sipas tij, përfaqësuesit e komunitetit të bizneseve janë mekanizmat kyç, të cilët më së mirë arrin ta korrektojnë punë që bënë ATK, si dhe të ofrojnë alternativa të cilat patjetër janë në harmoni me kornizat ligjore të

# Stafi i FMN-së pati një takim me drejtorin e ATK-së

Menaxhmenti i ATK-së, i kryesuar nga drejtori i ATK-së Ilir Murtezaj, në muajin maj pati një takim me një mision të Fondit Monetar Ndërkombëtar që ka qëndruar për vizitë në Prishtinë, për të diskutuar mbi performancën e të hyrave për vitin 2022.

Ekipi i FMN-së përbëhej nga z. Gabriel Di Bella, shef i misionit të FMN-së për Kosovën, si dhe ekipi i FMN-së në Kosovë. Z. Di Bella u njoftua në detaje për performancën e të hyrave të ATK-së, e cila deri në prill 2022 ka rezultuar me të hyra prej 269.4 milionë euro, që paraqet një rritje prej 34.1% krahasuar me vitin e kaluar. Z. Di Bella u shpreh se janë të kënaqur me performancën e të ardhurave, si dhe me progresin në zbatimin e rekomandimeve të asistencës teknike të FMN-së.

## Menaxhimi i përmbushjes së deklaramit tatimor

Administrata Tatimore e Kosovës në muajin maj ka marrë pjesë në punëtorin e organizuar nga Banka Botërore për shkëmbimin e përvojave në menaxhimin e përmbushjes së deklaramit tatimor. Përmes kësaj punëtorie është synuar të paraqesë qasje për të siguruar norma të larta të deklaramit në kohë për tatimet kryesore (Tatimi mbi të Ardhurat Personale (TAP), Tatimi mbi të Ardhurat e Korporatave (TAK) dhe Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH).

Veç tjerash gjatë kësaj punëtorie është diskutuar lidhur me boshllëqet në sistemin e menaxhimit aktual të përmbushjes së deklaramit, që praktikohet nga ATK-ja dhe opsionet për harmonizimin e menaxhimit të përmbushjes së deklaramit në Kosovë me praktikatat e mira ndërkombëtare, duke përfshirë përdorimin e qasjeve të sjelljes.

Punëtorja ka zgjatur dy ditë, përderisa pjesëmarrës përveç punonjësve të ATK-së ishin edhe përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare, si dhe në pjesën virtuale ishin ekspert nga administratat tatimore të rajonit.



## Drejtori i ATK-së ka prezantuar të arriturat e institucionit në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022



Niveli i lartë i inkasimit të të hyrave, rritja e efektit në trajtimin e borxheve, orientimi në përmirësimin e përmbushjes tatimore, ishin vetëm disa nga pikat e prezantuara në konferencë për media, si të arritura në institucionin e Administratës Tatimore të Kosovës për gjashtë muajt e parë të këtij viti.

Në këtë konferencë Ministri i Financave, Punës dhe Transferëve Hekuran Murati përgëzoi ATK-në dhe stafin për arritjet e bëra në gjashtëmujorin e këtij viti, po ashtu falënderoi edhe tatimpaguesit për kontributin që japin në zhvillimin e vendit duke paguar tatimet.

Tutje, Murati pati shprehur se për të rritur edhe më shumë suksesin e ATK-së duhet të punojmë në rritjen e besimit. Ai tha se planet e ministrisë janë që të forcojnë institucionet, duke rritur kredibilitetin dhe profesionalizmin, pasi që vetëm në këtë mënyrë do të rritet edhe më shumë besimi ndaj institucioneve e këtë rast ATK-së. Veç tjerash, ministri Murati tha se është i rëndësishëm formalizmi i ekonomisë, për të cilën ATK është duke zhvilluar kampanja sensibilizuese.

Drejtori i ATK-së Ilir Murtezaj gjatë prezantimit të konferencës përmendi faktorët të cilët kanë ndikuar në rritjen e të hyrave, si ajo e fuqizimit të kontrollit të brendshëm (ngritja e përgjegjësisë dhe llogaridhënies), rritja e efikasitetit në mbledhjen e borxheve, digjitalizimi i shërbimeve ndaj tatimpaguesve 100%, shërbimet profesionale, rritja e transparencës, rritja e bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, si dhe zbatimimi i rekomandimeve nga organizatat ndërkombëtare. Drejtori Murtezaj theksoi se inkasimi prej 355.5 milion euro tatime, ka shënuar rritje në krahasim me planin për 26.5 milion euro apo 8.1%. Po ashtu, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kemi rritje për 66.3 milion euro apo 22.9%.

Përmes kësaj konference u prezantuan edhe efektshmëria në trajtimin dhe inkasimin e borxheve, ku vetëm për këtë periudhë janar-qershor 2022 janë mbledhur 76.8 milion euro borxhe. Tutje, u theksua se digjitalizimi i shërbimeve si për tatimpagues dhe qytetar, ashtu edhe me institucionet bashkëpunuese janë indikator i rëndësishëm në realizimin e synimeve të institucionit.

ATK falënderon gjithë tatimpaguesit të cilët kryerjen më kohë të obligimeve tatimore, si dhe mediat për transmetim dhe informim të drejt për aktivitetet e ATK-së.



# Monitorimi i hotelerisë/gastronomisë, këngëtareve, stilisteve, si dhe salloneve të bukurisë

Zëvendësues Drejtori i Përgjithshëm i ATK Ilir Murtezaj në muajin gusht ka mbajtur konferencë për media, përmes së cilët ka njoftuar se ka realizuar aktivitete në teren të veprimtarisë e **gastronomisë/hotelerisë, këngëtarëve, stilistët, si dhe salloneve të bukurisë.** Murtezaj tha se Administrata Tatimore e Kosovës ka mbledhur informacione të ndryshme, të cilat e vërtetojnë aktivitetin e gastronomisë/hotelerisë, këngëtareve, stilistët, si dhe salloneve të bukurisë, ku për secilin kemi mjaftueshëm informata për të bërë vlerësime tatimore.

Tutje në këtë konferencë u theksua se sezoni i verës shumëfishon aktivitetet e lartpërmendura, të cilat bazuar në aktivitetin që kanë si një zinxhir, pasi që kryesisht në sezonin e verës janë shumë evidente ndeja të ndryshme, si në restorante ashtu edhe në diskoteka, në të cilat ndërliken pjesa e këndimit ose dj, si dhe përgatitja nga sallonet e bukurisë dhe stilistët. Për këtë qëllim në fillim të këtij viti kemi dizajnuar projektin për Akomodim dhe Shërbime Ushqimore, i cili bazuar në të dhënat e përmbushjes gjatë vitit 2021, renditet si njëra ndër industritë me nivel të lartë të mos-përmbushjes së detyrimeve tatimore, andaj edhe është pjesë e planeve specifike të përmbushjes për grupet e identifikuara me rreziqe të larta për vitin 2021.

Murtezaj, ndër të tjera përmendi problemet më specifike, të dala nga sistemet dhe modulet e ndërtuara përbrenda ATK-së, të cilat kanë kontribuar në këtë përzgjedhje të trajtimit të kësaj industrie “pagesa përgjithësisht të ulëta, me një kontribut të vogël në të hyra, pavarësisht numrit të madh të tyre; mos-

deklarimi i punëtorëve dhe pagesa cash e tyre; mos-deklarimi apo nën-deklarimi i ahengjeve dhe mos-mbajtja e evidencave lidhur me këngëtarët gjatë mbrëmjeve muzikore; mos-lëshimi i kuponëve fiskal; pagesat po ashtu në cash të realizuara në mes të konsumatorëve dhe bizneseve gjatë organizimit të ahengjeve të ndryshme; si dhe mos mbajtja e tatimit në qira apo nën-deklarimi i saj”.

Në fund të kësaj konference drejtori i ATK-së paralajmëroi se para së të fillojmë me vlerësimet tatimore, kontrollet në përmes kësaj konference i bëjmë thirrje të gjithë personave, bizneseve, të cilat gjatë sezonës së verës kanë pasur aktivitete të shtuar të deklaroj dhe paguajnë saktë obligime të tyre që i përcakton Legjislacioni Tatimor në fuqi, në të kundërtën në jem të obliguar që të fillojmë me hapjen e kontrolleve, si dhe ndëshkimet për mos deklarim, e cila sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës konsiderohet si vepër penale.

Mesazhi për tatimpaguesit nga z.Murtezaj në konferencë ishte:“I bëjmë thirrje që deri në afatet e rregullta me datën 20 të muajit shtator dhe 15 tetor, të deklarojnë dhe paguajnë obligimet tatimore, pasi që pas këtyre afateve veprimet e ATK-së nuk do të jenë më thirrje por veprime konkrete”.

# Takim me palët e interesit për trajtimin e mallit pa dokumentacion



Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në fushën e trajtimit të mallit pa dokumentacion, si dhe mungesës në stoqe, në muajin shtator ekipi i cili menaxhon me këtë projekt ka mbajtur takim me palët e interesit.

Në këtë takim z. Nahit Sharku, Zëvendësues i Drejtorit të Departamentit për Programe dhe Procedura foli për përmirësimin e përmbushjes tatimore në sektorin e tregtisë me shumicë, duke përfshirë të gjithë faktorët që ndikojnë dhe ndikohen nga ky sektor në mënyrë më të fokusuar dhe më të koordinuar.

Po ashtu, palët e interesit u njoftuan edhe për grupet e synuara për trajtim përmes këtij projekti, si ajo e industrisë së tekstilit, tregtia me shumicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, tregtia me shumicë e artikujve shtëpiakë, tregtia tjetër me shumicë e specializuar, tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara, tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara, tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara, dhe të tjera

E nga ana tjetër, znj. Valbona Ymeri, Udhëheqëse e Sektorit të Hetuesisë nga Dogana e Kosovës tha se si çdoherë jemi të gatshëm t'i bashkërendojmë aktivitetet, pasi që dukuria e kontrabandës është edhe prioritet i institucionit të Doganës.

Majori Blerim Rama, Drejtori i Operativës nga Policia Kufitare e Kosovës, përgëzoi ATK për projektin, duke shtuar se nga ana e Policisë si çdoherë do të ofrohet mbështetja dhe asistimi në çdo aksion.

Znj. Nexhmije Krasniqi nga Departamenti Ligjor i OEK, tha se çdo nismë e ATK do të gjejë përkrahjen e organizatës tonë, pasi që vetëm në këtë mënyrë do të arrijmë të kemi barazi në të bërit biznes.

Në fund të këtij takimi u tha se ekziston ende një numër i konsiderueshëm i tatimpaguesve, të cilët kanë problemin e mallit pa dokumentacion si rezultat i blerjeve pa fatura, po ashtu shitje të pa deklaruara. Bazuar në të dhënat e përmbushjes gjatë vitit 2021, shihet se dukuria e mallit pa dokumentacion renditet si ndër dukuritë me nivel të lartë të riskut dhe janë identifikuar si aktivitete më me risk.

# Tryezë e diskutimi për Të Dhënat e Hapura ('Open Data') në Administratën Tatimore të Kosovës



Administrata Tatimore e Kosovës në bashkëpunim me Programin e USAID për Qeverisje Ekonomike në Kosovë, në muajin tetor kanë organizuar Tryezë të Rrumbullakët për të Dhëna të Hapura ('Open Data') në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK).

Qëllimi kësaj nisme (Open Data) sigurisht është rritja e transparencës, përmirësimi i perceptisionit të institucionit të ATK-së për publikun, njëherit edhe zhvillimi i hovshëm i teknologjisë informative, e cila mundëson të shërbej qytetarët me të dhëna në kohë reale. Veç kësaj, shkas i kësaj iniciative, e cila ka qenë paraparë edhe në Planin për Përmirësimin e Integritetit të ATK-së, kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë kërkesat e shumta që vijnë nga organizatat të ndryshme nga vendi dhe jashtë.

Andaj, në këtë tryezë të ftuar ishin institucione dhe organizata vendore dhe ndërkombëtare, si dhe media nga të cilat është kërkuar dhënia e inputeve, të cilat janë me interes publik për finalizimin e Katalogut për Të Dhëna të Hapura. Pjesëmarrësit kanë mirëpritur këtë projekt, të cilin e cilësuan si mekanizëm i cili do të ngreh në nivel tjetër, transparencën dhe integritetin e institucionit të ATK-së.

Sipas statusit aktual të Katalogut për Të Dhëna të Hapura, brenda këtij viti do të publikohen data-sets e para.

Hapja e të dhënave është çelës për çdo institucion e organizatë për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies. ATK çdoherë ka qenë e fokusuar përmes planeve strategjike në rritjen e mekanizmave, të cilën qojnë përpara integritetin e institucionit. Iniciativa për hapjen e të dhënave kontribuon direkt në zhvillimin demokratik të një institucioni, si dhe zhvillimin e një segmenti ekonomike në nivel inovativ.



# Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2022 vlerëson lartë punën e ATK-së

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2022, i cili është publikuar së fundi, ka raportuar për progresin e shënuara të ATK-së në lidhje me mbledhjen e tatimeve, bashkëpunimit ndërinstitucionalë, si dhe shërbimeve ndaj tatimpaguesve.

Referuar pjesës ku raporti thekson inkasimin e të hyrave thuhet se “Progres i mirë është bërë gjatë periudhës raportuese në lidhje me mbledhjen e tatimeve, ku të ardhurat e përgjithshme për vitin fiskal 2021 ishin 19% më të larta se në vitin 2020 (të hyrat e përgjithshme, ATK & Dogan). Totali i tatimeve të mbledhura për gjashtë muajt e parë të 2022 është më i lartë për 16% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021. Kjo është për shkak të aktivitetit të fuqishëm ekonomik pas lehtësimit të kufizimeve të pandemisë COVID-19 dhe përmirësimit të përmbushjes tatimore, por të kompensuar nga normat e larta të inflacionit”.

Tutje, brenda kapitullit 16, ku vlerësohet pjesa e tatimeve thuhet se sistemi i TVSH-së është gjerësisht i përafuar me acquis të BE-së (legjislacioni i BE-së). Kosova aplikon një normë standarde prej 18% dhe një normë të reduktuar prej 8%. Ligji për TVSH-në duhet të harmonizohet më tej me acquis të BE-së (legjislacioni i BE-së). Duhet të vendoset korniza ligjore dhe procedurat për tatimin në tregtinë elektronike. Kosova e ka reduktuar kohën mesatare të rimbursimit të TVSH-së në 19 ditë, nga maksimumi ligjor prej 30 ditësh.

Sa i përket kapacitetit operacional dhe automatizimit, Administrata Tatimore e Kosovës ka zhvilluar një cilësi të mirë të shërbimit, veçanërisht me përdorimin e gjerë të deklarimeve elektronike dhe pagesave elektronike.

Në fund të raportit thuhet se Administrata Tatimore ka miratuar një plan strategjik katërvjeçar për të përmirësuar mbledhjen e tatimeve, për të reduktuar hendekun tatimor dhe për të përmirësuar kapacitetin e saj institucional i cili aktualisht është në zbatim. Gjatë periudhës raportuese, Administrata Tatimore ka intensifikuar veprimet e saj për përmbushjen tatimore të bazuar në rrezik.



# Konferenca rajonale e CEF në Kosovë: shembulli i ATK-së në reformën e mbledhjes së detyrueshme



Për herë të parë në Kosovë është organizuar konferenca ndërkombëtare nga CEF (Qendra e Ekselencës Financiare, Slloveni), në bashkëpunim me FMN-në, Administratën Tatimore të Kosovës dhe Autoritetin Tatimor të Holandës, lidhur me suksesin e Konsolidimit të Mbledhjes së Detyrueshme. Në ditën e dytë të kësaj konference mori pjesë Kryeministri i Republikës së Kosovës Albin Kurti, i cili shprehu kënaqësinë që ishte i

pranishëm në këtë punëtori. Kryeministri i vendit tha se fakti që këto institucione të respektuara ndërkombëtare po e konsiderojnë Administratën Tatimore të Kosovës si rast studimor për të mirë, tregon për përkushtimin, përgjegjshmërinë dhe profesionalizmin në rritje të këtij institucioni.

Ndërsa, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve Hekuran Murati, i cili po ashtu ishte i pranishëm në konferencë tha se bashkëpunimi i ATK-së me institucionet e tjera ka bërë që të ketë performancë më të mirë të të hyrave.

Ndër tjera, ministri Murati ka potencuar se ATK në vazhdimësi do të ketë mbështetjen nga Ministria në realizimin e objektivave të saj.

“Ngjarje si kjo na mundësojnë avancimin e komunikimit. Ky bashkëpunim na ndihmon edhe në rritjen e efikasiteti në mbledhjen e tatimeve”.

“ATK ka treguar performancë në realizimin e të hyrave tatimore, si dhe ka shënuar progres edhe sa i përket reformës në mbledhjen e borxheve. Së fundmi unë si ministër do të vazhdojë mbështetjen për ATK-në të cilët synojnë rritjen e efikasitetit të institucionit”.

Drejtoresha Ekzekutive e CEF Jana Repansek, tha se ATK-ja po ndërmerr hapa të rëndësishëm drejt zhvillimit, duke thënë se do ta ndihmojnë këtë institucion me ekspertë të fushës së tatimit. Ajo shtoi se së bashku kemi krijuar ekspert në sektor publik që kërkojnë mbështetje të veçantë.



# Konferenca rajonale e CEF në Kosovë: shembulli i ATK-së në reformën e mbledhjes së detyrueshme

Drejtori i ATK-së Ilir Murtezaj fillimisht falënderoj CEF që ka zgjedhur ATK dhe Kosovën për mbajtjen e kësaj konference dhe pikërisht reformat e bëra nga ATK në mbledhjen dhe trajtimin e borxheve si shembull për autoritetet tatimore të shteteve të tjera.

Ai tha se administrata tatimore veç sektorit të mbledhjes së borxheve ka bërë edhe reforma të tjera, të cilat kanë reflektuar që institucioni ynë të ketë progres të jashtëzakonshëm në performancën e saj, si në inkasimin e të hyrave, në uljen e stokut të borxhit, por edhe në automatizimin e shërbimeve ndaj tatimpaguesve.

Në këtë konferencë janë ndarë përvojat tona me vendet tjera, kjo pasi ATK ka ndryshuar qasjen e saj organizative për menaxhimin e borxhit tatimor duke dëshmuar progres të madh gjatë viteve të fundit.



Pjesëmarrës në këtë workshop janë përfaqësues nga CEF-i, FMN, ATK, AT e Holandës, Shqipëria, Bullgaria, Rumania, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut.

Konferenca është mbajtur me datë 25, 26 dhe 27 tetor 2022.



## Përfaqësues nga Ambasada e SHBA-së në Kosovë ishin në takim me drejtorin Murtezaj



Drejtori i Përgjithshëm ATK-së Ilir Murtezaj me bashkëpunëtorët e tij kanë pritur në takim z.Diar Seckinger Shef i Njësisë Ekonomike në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë me ekipin e tij, si dhe Dardane Peja nga USAID.

Takimi ishte në frymën e bashkëpunimit dhe mbështetjes së vazhdueshme që qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përmes projekteve të ndryshme i kanë ofruar ATK-së, në reformimin e shumë proceseve, të cilat kanë dhënë rezultate të jashtëzakonshme në performancën e ATK-së.

Ajo çka u diskutua me theks në këtë takim ishte trendi i inkasimit të të hyrave tatimore, për të cilat u njoftuan në detaje rreth faktorëve që kanë ndikuar në rritjen prej 28% të të hyrave tatimore në vitin 2021, respektivisht rritjes prej 22 % në dhjetë mujorin e vitit 2022, të cilat rezultate janë më të larta që nga themelimi i institucionit tatimor. Po ashtu, u diskutua edhe për pritjet lidhur me vazhdimin e trendit rritës në vitet 2023 dhe 2024.

## Fushata 5 ditore për sensibilizim të formalizmit të punësimit

Administrata Tatimore e Kosovës në bashkëpunim me organizatën Iniciativa Kosovare për Stabilitet dhe Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve në dhjetor ka përmbyllur fushatën 5 ditore për sensibilizimin e formalizmit të punësimit.



Kampanja në fjalë është realizuar në qytete të ndryshme, ku fokusi kryesor ishte që qytetarët të njoftohen me rëndësinë e të qenit të regjistruar si punëtor, si dhe përfitimet nga formalizmi. Po ashtu, gjatë këtyre takimeve i është dhënë theks i veçantë zhvillimit të dialogut social, si faktor shumë i rëndësishëm në këtë segment.

Gjatë diskutimeve që u zhvilluan për këto pesë ditë, pjesëmarrësit ngritën shqetësimet e tyre kryesisht në pjesën e mos regjistrimit, mos respektimit të kushteve, punësimi i të rinjve nën moshën e lejuar me ligj dhe shumë të tjera të cilat kryesisht lidhen me temën e fushatës. Veç tjerash pjesëmarrësit u njoftuan edhe me mekanizmat që kanë në dispozicion nga ana e ATK-së për të raportuar rastet kur ata dyshojnë se nuk janë të regjistruar-konkretisht ata u njoftuan me veglën për verifikim të punëtoreve <https://apps.atk-ks.org/regemployer> si dhe linjën për raportim **0800 80 800**.



ATK është duke implementuar projektin për Formalizmin e Punësimit nga viti 2021, ndërsa fushata është realizuar në kuadër të projektit “Drejt drejtësisë dhe barazisë sociale” përmes Human Rightivism, që mbështetet nga ambasada e Suedisë në Kosovës nëpërmjet Fondit për Zhvillim Komunitar.


# Sesioni informues me bizneset e diasporës



Në pjesën e parë të muajit dhjetor, në Bruksel është mbajtur sesioni informues me bizneset e diasporës më temën: “Mjedisi i biznesit dhe klima e investimeve në Kosovë”.

Përfaqësuesi nga ATK, z. Sami Salihu Drejtor i Departamentit për Regjistrim dhe Shërbim të Tatimpaguesve, ka prezantuar funksionimin e sistemit tatimor në Kosovë, me theks të veçantë përparësitë e sistemit tatimor. Ajo çfarë u theksua në këtë sesion ishte informimi se ligjet tatimore në Kosovë dhe aktet nënligjore janë të bazuara në standardet ndërkombëtare dhe parimet e BE-së.

Po ashtu, z. Salihu përmendi edhe reformat e institucionit të ATK-së si mjedis i përshtatshëm biznesor, duke ofruar të gjitha shërbimet për tatimpaguesit në mënyrë elektronike. Gjithashtu, bizneset e diasporës u njoftuan se në Kosovë normat tatimore janë të ulëta dhe më të favorshme krahasuar me vendet në rajon dhe gjetiu, si dhe të gjitha tatimet deklarohen në mënyrë elektronike. Pjesëmarrësit nga diaspora u njohën me progresin e ATK-së në inkasimin e të hyrave, lehtësirat në pagesën e tatimeve, si dhe për synimet e ATK-së në të ardhmen.



Ky aktivitet është bashkërenduar mes Ambasadës së Republikës së Kosovës në Belgjikë dhe Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë.



## Konferenca vjetore për media



Përmes një konference për media Administrata Tatimore e Kosovës ka prezantuar të arriturat dhe sfidat e vitit 2022. Drejtori Ekzekutiv i ATK-së Ilir Murtezaj gjatë fjalës hyrëse të tij, falënderoj mediat për informim të drejtë të opinionit publikë, rreth aktiviteteve të autoritetit tatimor.

Vitin 2022 do ta karakterizoj tejkalmi i të gjitha parashikimeve në mbledhjen e të hyrave për buxhetin e shtetit, të cilat shënojnë 721.6 milion euro, që i bie se përveç realizimit të planit për këtë vit, ATK ka arritur të inkasoj mbi 10 milion euro më shumë se plani i rishikuar. Rritje dhe tejkalm të të hyrave kemi edhe nëse krahasojmë këtë vit me vitin 2021, ku shifrat shkojnë në 124 milion euro.

Mbledhja e të hyrave nuk janë i vetmi indikatorë që ATK ka shënuar progres këtë vit, progres ka edhe në trajtimin e borxheve tatimore, tek të cilat është arritur të kemi 152.2 milion euro borxh të mbledhur. Veç kësaj, këtë vit janë ndërmarr një numër i konsiderueshëm i aksioneve për konfiskim të borxheve ndaj tatimpaguesve, të cilët nuk i kanë respektuar afatet dhe kushtet për t'i kryer obligimet tatimore, prezantoj z. Murtezaj.

Fokusi i ATK-së këtë vit ka qenë më theks të veçantë edhe në përmirësimin e përmbushjes

tatimore, në sektorët të cilat sipas analizës së riskut kanë paraqitur hendek tatimor. Për të pasur rezultat ATK ka punuar që të ketë trajtim sektorial, përmes 5 projekteve të cilat janë duke trajtuar sektorin e ndërtimtarisë, punësimit joformal, gastronomisë dhe hotelerisë, mallit pa dokumentacion/mungesa në stoqe, si dhe mos-deklaruesit.

ATK gjatë vitit 2022 u vlerësua lartë për performancën e saj nga të gjitha institucionet ndërkombëtare të cilat bëjnë monitorimin e punës së ATK-së, sikurse raportet e vlerësimit nga: FMN-ja, raporti i KE-së, OECD-së, USAID, si dhe vlerësimet nga Ambasada e Britanisë së Madhe dhe institucionet tjera.

Në kuadër të këtyre informacioneve, drejtori i ATK-së përmendi hetimet që janë kryer karshi monitorimit të rrjeteve sociale përmes veglës analitike, tek të cilat është konstatuar 1.9 milion euro qarkullimi shtesë.

Tek pjesa e bashkëpunimit me qytetarë për evazion tatimor, të cilët kanë shfrytëzuar kanalet e raportimeve, siç janë; linja pa pages 0800 80 800, vegla për verifikim të punëtorëve dhe kutia e vërejtjeve, janë raportuar 2,379 raste, ku pas verifikimeve në teret janë lëshuar 1,087 gjoba.

# Manuali për procedura të Hetimeve Tatimore



Mbështetur nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, përmes një ceremonie protokollare është finalizuar Manuali për procedura të Hetimeve Tatimore.

ATK falenderon GIZ Kosovo për përkrahjen e vazhdueshme dhënë institucionit, në procese të ndryshme të punës.



# Statistika

## Vizitat tek tatimpaguesit

Gjatë këtij viti janë realizuar 36,502 vizita përmbushëse tek bizneset me veprimtari të ndryshme, ku si rezultat i gjetjeve në teren janë lëshuar 11, 910 gjoba në vlerë 3.5 milion euro. Veç kësaj, gjatë këtyre aktiviteteve janë lëshuar 468 gjoba për mallin pa origjinë, si dhe mungesë në stoqe në vlerë 41.4 milion euro.

## Kontrollet tatimore

Krahas vizitave, gjatë këtij viti janë kryer 1,893 kontrolle, tek bizneset, ku si rezultat janë konstatuar 37 milion euro tatim bazë+ndëshkim+interes.


## Rimbursimet

Trajtimi i kërkesave për rimbursim brenda 30 ditëve (sipas praktikave ndërkombëtare) dhe sipas afateve të legjislacionit vendor.

Viti 2022	Kërkesa								
	Numri	Shuma e aprovuar	Obligime	Transfer	Kat-A	Kat-B	Kat-C	Tot. A+B+C	Mesatarja ditë
Rimbursimet e Aprovuara	803	65,852,050	9,025,797	56,826,253	247.00	362.00	194.00	803	22.8
Rimbursimet e refuzuara	608	28,028,098	0	0.00	162.00	430.00	16.00	608	13.37
<b>Totali</b>	<b>1,411</b>	<b>65,852,050</b>	<b>9,025,797</b>	<b>56,826,253</b>	<b>409</b>	<b>792</b>	<b>210</b>	<b>1,411</b>	<b>18.08</b>

# Struktura organizative

## STRUKTURA ORGANIZATIVE E ADMINISTRATËS TATIMORE TË KOSOVËS



Zv. Drejtori Ekzekutiv 1 ATK-së:

Ilir Murtezaj:

04.10.2022



\*Rregullorja (ZKM) Nr. 02/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të Kosovës është miratuar nga Kryeministri, me Vendimin Nr. 386/2022, të datës 23.09.2022.

# Multimedia

Plani Strategjik 2022—2026:

<https://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2022/08/LEAFLET-ATK-STRATEGY-PLAN-ALB.pdf>

Marrëveshjet për Eliminim e Tatimit të Dyfishtë (METD):

<https://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2022/08/OUTLINE-ALB-21-06-METD-BROSHURA.pdf>

Karta për Tatimpaguesit:

[https://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2022/09/Tatim\\_paguesi\\_Shqip.pdf](https://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2022/09/Tatim_paguesi_Shqip.pdf)

Mos-deklaruesit:

<https://www.youtube.com/watch?v=JICdEWom3ls>

Formalizmi punësimit:

<https://www.youtube.com/watch?v=8lgTDkMUsiU>

Regjistrimi

<https://www.youtube.com/watch?v=qJySstEveRU>

Deklarimi:

<https://www.youtube.com/watch?v=MJpK1FkPqUA>

Pagesa:

<https://www.youtube.com/watch?v=ggdVjHigMA0>

Dokumentim:

<https://www.youtube.com/watch?v=KTQS-VWGIZo>

Deklarimi vjetor i tatimit CD për OJQ-të:

<https://www.youtube.com/watch?v=SZ4aYFR1Qh8>